

Jahë Jusufi

Lindur më 1948 në fshatin Plluzhinë. Shkollën fillore e kreu në Ticë, tetë vjeqaren në Likoc, ndërsa shkollën e mesme normale në Mitrovicë (1968).

Shkollën e Lartë Pedagogjike (Gjuhë dhe Letërsi) në Gjakovë, ndërsa më 1981 diplomoi në Fakultetin filozofik (Gjuhë dhe letërsi shqipe).

Më 1968 u emrua arsimtar në Likoc ku ligjëroi gjuhën shqipe dhe edukatën muzikore deri më 1995 kur emrohet drejtor në fillim në Likoc, e pas pak kohësh kalon po ashtu drejtor në shkollën fillore “ 2 Korriku “ në Ticë deri më 31 01.2007.

Gjatë punës së tij edukativo-arsimore disa herë u shpërblye me mirënjohje; udhëhoqi me sukses grupin koral, grupin muzikor të shkollës si dhe grupin e recituesve me të cilët disa herë zuri vendin e parë në nivel komunal. Më 1981 u dënua me një muaj burg si nxitës i nacionalizmit duke u bazuar në disa tema hartimesh ku për ish pushtetin ishin nxitëse të nacionalizmit.

Në pajtimin e gjaqeve (1990) bashkë me Muharrem Dërgutin nga Rezalla dhe mulla Zeqir Hoxhën nga Plluzhina ishin ndër veprimtarët më të dalluar.

Gjatë luftës së viteve 1998/99 ishte kryetar i Këshillit të Emergjencës, këshill që u lavdërua për punë të ndërgjegjshme dhe që dha një kontribut të jashtëzakonshëm.

Menjëherë pas luftës ishte ndër trajnues të dalluar në programet psiko-sociale (veçmas me Kryqin e Kuq Danez) ku mori mirënjohje. Është bashkëpunëtor i revistës “ Shkëndija “. Tani është i pensionuar.

